



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE SOCIALE, ARSIMIT DHE RINISË

Nr. 762/prot.

Himarë, më 23.01 .2025

PROJEKTVENDIM

Nr. 3 datë, 23.01 .2025

BASHKËFINANCIMI PREJ 50% TË VLERËS DO TË APLIKOHET NË DY PROGRAMET E STREHIMIT: PËR RESTAURIMIN E BANESAVE SHUMË TË AMORTIZUARA PËR FAMILJET NË NEVOJË DHE PËR PROGRAMIN E STREHIMIT TË PËRKOHSHËM, SI DHE PËR ADAPTIMIN E OBJEKTEVE EKZISTUESE, NË KUADËR TË ZBATIMIT TË PROJEKTIT TË STREHIMIT SOCIAL PËR VITIN 2025.

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, vendimit nr. 42, datë 20.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Himarë për vitin 2025” të Këshillit Bashkiak Himarë,

VENDOSI:

1. Restaurimin e banesave shumë të amortizuara në zbatim të projektit të strehimit social për vitin 2025 sipas pikës 7 të udhëzimit nr. 31, datë 18.11.2019, “Për procedurat standarde të aplikimit dhe kriteret e përfitimit të fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit”.
2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i Bashkisë Himarë për vitin 2025 dhe fondit të strehimit social që Ministria e Financave do t’u jap bashkive për të përballuar kostot totale të projektit për përmirësimin e kushteve $\leq 70\%$ të kostos së ndërtimit të një objekti të ri referuar kostos mesatar të ndërtimit në fuqi miratuar me VKM nr.3, datë 28.12.2016 dhe referuar normave të strehimit në fuqi sipas anëtarëve të një familjeje bazuar në certifikatën familjare.
3. Ngarkohet drejtoria e çështjeve sociale, arsimit dhe rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

KRYETARI I BASHKISË

Vangjel Tavo

DREJTORI

Aida Halilaj

DREJTORIA JURIDIKE

Ardit Muhametaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE SOCIALE, ARSIMIT DHE RINISË

Nr. 762/prot.
2

Himarë, më 23.01.2025

RELACION SQARUES

Lënda: Për bashkëfinancimin prej 50% të vlerës do të aplikohet në dy programet e strehimit: për restaurimin e banesave shumë të amortizuara për familjet në nevojë dhe për programin e strehimit të përkohshëm, si dhe për adaptimin e objekteve ekzistuese, në kuadër të zbatimit të projektit të strehimit social për vitin 2025.

KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË

Nisur nga shkresa me nr. 15900 prot., datë 18.12.2024 nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, protokolluar në institucionin tonë me 8184 prot., datë 26.12.2024, mbi fondet për programin e strehimit për vitin 2025 drejtuar bashkive për të aplikuar për strehim social për individët në nevojë Drejtoria e çështjeve sociale, arsimit dhe rinisë, konkretisht sektori i ndihmës sociale dhe strehimit ka menduar që të aplikohet në këtë thirrje nëpërmjet bashkëfinancimit për t'u ardhur në ndihmë disa familjeve që jetojnë në kushte të vështira ekonomike duke restauruar banesat ekzistuese të tyre në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social" si dhe Strategjisë së Strehimit Social 2016-2025, i miratuar me VKM me nr. 405, datë 01.06.2016. Bashkia Himarë nisur dhe nga referencat për të ardhurat për frymë për vitin 2023 si dhe kufijtë e financimit do të kontribuojë në bashkëfinancim në masën 50% nga buxheti i shtetit, në varësi të nivelit të të ardhurave për frymë që është me vlerën 44,394 lekë sipas referencave të ministrisë.

Për sa më sipër numri i familjeve që kërkojnë restaurim të pjesshëm të banesave është 8 (tetë), konkretisht 5 (pesë) në njësinë administrative Horë-Vranisht dhe 2 (dy) në njësinë administrative Lukovë dhe 1 (një) në njësinë administrative Qendër. Familjet janë si më poshtë:

- a. Sotir Trakaj- Fshati Bolenë, njësia administrative Horë-Vranisht, familje me 5 anëtar, madhor, e cila trajtohet me ndihmë ekonomike dhe njëri prej anëtarëve si person me aftësi të kufizuar.

- b. Ismail Shehaj- Fshati Vranisht, njësia administrative Horë-Vranisht, familje me 5 anëtar,dy prej tyre të mitur, trajtohen me ndihmë ekonomike,
- c. Zenel Hasanaj- Fshati Vranisht, njësia administrative Horë-Vranisht, i moshuar i vetmuar i cili trajtohet me ndihmë ekonomike,
- d. Ilirjan Guxhaj- Fshati Vranisht, njësia administrative Horë-Vranisht, 4 anëtar në familje,madhor të trajtuar me ndihmë ekonomike,
- e. Shuko Cacaj- Fshati Bolenë, njësia administrative Horë-Vranisht, dy anëtar madhor pensionist të trajtuar me ndihmë ekonomike dhe nipin e mitur.
- f. Astrit Balili- Fshati Çorraj, njësia administrative Lukovë, 5 anëtar,madhor me probleme të shëndetit mendor.
- g. Sose Zhupa- Fshati Fterrë, njësia administrative Lukovë, 2 anëtar,madhor të trajtuar me ndihmë ekonomike.
- h. Mira Belina- Fshati Qeparo, Njësia administrative Himarë, dy anëtar,njëri prej tyre i mitur të trajtuar me ndihmë ekonomike.

Gjithashtu në kategorinë e programit streha të përkohshme, për adaptim objekti ekzistues janë parashikuar 2 (dy) familje si më posht në njësinë administrative Lukovë :

- a. Jonida Alike- Fshati Borsh, njësia administrative Lukovë, 7 anëtar në familje, ku 4 prej tyre fëmijë të mitur dhe një pensionist. Familja nuk jetojnë në objektin e tyre prandaj është e nevojshme një strehë e përkohëshme kontenier pasi kryefamiljarja është e paralizuar.
- b. Fitim Dinaj- Fshati Lukovë, njësia administrative Lukovë, 4 anëtar në familje dy prej tyre të mitur, kjo familje jeton në një kasolle të sajuar me plasmas.

Për sa ju parashtruar në këtë relacion, bazuar në kërkesat e nenit 54 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetqeverisjen vendore”, kërkojmë miratimin e këtij projektvendimi nga ana e Këshillit Bashkiak.

KRYETARI I BASHKISË

Vangjel Tavo

DREJTORI
Aida Hakilaj

DREJTORIA JURIDIKE

Ardit Muhametaj

